

Ministri Olldashi: 2012, vit vendimtar për portin detar

12.01.2012



Viti 2012 do të jetë një vit vendimtar për portin detar të Durrësit-tha sot në mesditë ministri i Punëve Publike dhe Transporteve, Sokol Olldashi në përfundim të inspektimit të punimeve të rikonstruksionit në kalatën lindore të këtij porti.

I shoqëruar nga drejtori i përgjithshëm i Autoritetit portual, Eduard Ndreu dhe drejtuesit e kompanisë ndërtuese “Vega” ministri Olldashi u njoh me ndryshimet në këtë pjesë të portit më të madh të vendit.

Duke iu përgjigjur interesimit të mediave të pranishme, z. Olldashi tha se “brenda këtij sezoni do të përfundojë rikonstruksioni i kalatës nr 10 si dhe ai i terminalit të udhëtarëve. Ndërkaq do të nisnin edhe punimet e thellimit të kanalit hyrës dhe basenit, çka do të mundësojë hyrjen në portin detar të anijeve me kapacitet 30-40 mijë ton”.

Sipas Olldashit punimet aktuale në port që arrijnë vlerën e përgjithshme të investimit prej 28 milion euro, mbështeten nga privatizimi i shërbimeve si dhe dhënia me koncesion e terminalit të kontejnerëve, çka përbën një paketë tërësore të ndryshimeve pozitive në këtë infrastrukturë gjigande të vendit.

Ministri Olldashi falenderoi kompaninë zbatuese të projektit si dhe drejtorinë e Autoritetit Portual. “Perfomanca shumë e mirë financiare e APD na lejon që vlera e investimeve të qeverisë shqiptare të dyfishohet me financimet e vetë portit detartha më tej ministri Sokol Olldashi.

Kalata lindore, e njohur si kalata nr 10 po rikonstruktohet me financimin prej 1.129.015.140 lekë (8 milion euro) nga Autoriteti portual.

Punimet pritet të përfundojnë në fillim të muajit qershor të këtij viti. Ato përfshijnë një gjatësi prej 270 metra kalatë, me një sipërfaqe të përgjithshme ku përfshihen edhe sheshet pas kalatës prej 15.900 metra katrorë.

Sipas të dhënave të kompanisë Vega deri tani janë vendosur 159 nga 235 pilota gjithsej, secila me një gjatësi prej 45 metra dhe diametër 1.5 metër, të cilat krijojnë një kapacitet bartës të kalatës dhe sheshit përkatësisht nga 6 deri në 20 ton/metër katrorë.



